

VENDIM
Nr. 760, datë 13.12.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I RRUGËS ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË (FAZA III)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugës Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë (faza III)”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 684 342 (gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e dyzet e dy) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 684 342 (gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e dyzet e dy) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.
 8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTT “ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË (FAZA III)”

Nr. rendor	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)					VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa e pasurisë	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale				
									Sip. e shpronësuar (m²)	Cnimë (leke/m²)	Vlera (leke)	
1	Qemal	Mustafa	Tola	Mirake	2696	151	are	296	190	174	33,060	Pasuria nr. 150 bllokohet në favor të Fondit Besa, me k. noteriale 125, rrp. 291, datë 16.4.08
2	Qemal	Mustafa	Tola	Mirake	2696	150	are	2653	194	174	33,756	
3	Shvryri	Mustafa	Tola	Mirake	2696	142	are	1620	390	174	67,860	
4	Arslan	Ramazan	Lleshi	Mirake	2696	135	are	2400	889	174	154,686	
	Xhermal	Ramazan	Lleshi	Mirake	2696							
	Agim	Ramazan	Lleshi	Mirake	2696							
	Idlan	Ramazan	Lleshi	Mirake	2696							
5	Refat	Ramazan	Lleshi	Mirake	2696	122	are	1800	297	174	51,678	
	Qemal	Ramazan	Lleshi	Mirake	2696							
6	Sefedin	Musa	Hasani	Mirake	2696	73	are	881	284	174	49,416	
7	Kasem	Hali	Hasani	Mirake	2696	67	are	930	189	174	32,886	
8	Hava	Hamit	Hasani	Mirake	2696	60	are	910	71	174	12,354	
	Bledar	Ferit	Hasani	Mirake	2696							
9	Nercila	Ferit	Hasani	Mirake	2696	121	are	1070	28	174	4,872	
	Ab	Mushi	Mirake	2696								
	Maksim	Xhemë	Mushi	Mirake	2696							
10	Xhermal	Musa	Hasani	Mirake	2696	56	are	1283	3	174	522	
11	Sofofiki	Koli	Bualli	Mirake	2696	147/1	are	1200	377	174	65,598	
12	Fatmir	Hali	Hasani	Mirake	2696	59	are	800	37	174	6,438	
13	Mustafa	Mvift	Ymeni	Mirake	2696	143/4	are	2590	984	174	171,216	
	Anjana	Mustafa	Ymeni	Mirake	2696							
									Vlera totale			684,342